

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË ANEKSIN VI TË KONVENTËS NDËRKOMBËTARE DETARE “PËR PARANDALIMIN E NDOTJEVE NGA ANIJET, 1973”, TË NDRYSHUAR ME PROTOKOLLIN E VITIT 1978 (MARPOL 73/78)”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Miratimi i projektligjit synon të plotësojë kuadrin ligjor në fushën e mbrojtjes së mjedisit detar nga ndotjet nga anijet.

Në kuadrin e strategjisë së Republikës së Shqipërisë për integrimin në familjen ndërkombëtare detare dhe në Bashkimi Evropian, një nga konventat më të rëndësishme në fushën e transportit detar është dhe konventa ndërkombëtare detare për parandalimin e ndotjeve nga anijet e vitit 1973/1978 (MARPOL 73/78).

Me ligjin nr.9594, datë 27.7.2006, Republika e Shqipërisë aderoi në konventën ndërkombëtare detare “Për parandalimin e ndotjeve nga anijet, 1973” të ndryshuar me protokollin e vitit 1978 (Marpol 73/78) së bashku me pesë anekset e kësaj konvente, si më poshtë vijon:

Aneksi I: Rregulla për parandalimin e ndotjes nga nafta, ku parashikohen rregulla teknike që duhet të zbatohen nga anijet për parandalimin nga ndotja e hidrokarbureve, si dhe certifikimi i anijeve e modeli i certifikatave që duhet t’u lëshohen anijeve.

Aneksi II: Rregulla për parandalimin e ndotjes së detit nga lëndët likuide helmuese që transportohen rifuxho me anije, ku përfshihen të gjitha procedurat teknike lidhur me këtë kategori mallrash.

Aneksi III: Rregullat për parandalimin nga ndotjet për substancat e dëmshme që transportohen me anije në formë të paketuar. Këtu përfshihen të gjitha masat dhe procedurat teknike që kërkohen për të transportuar këto mallra, duke parandaluar ndonjë ndotje të mundshme.

Aneksi IV: Rregulla për parandalimin e ndotjes nga ujërat e zeza të anijeve, duke kërkuar pajisje të veçanta në anije, ku ato të depozitohen, si dhe mënyrën e regjistrimit të tyre.

Aneksi V: Rregulla për parandalimin e ndotjeve që mund të shkaktohen nga mbetjet e krijuara në anije, ku përfshihen mënyra e depozitimit të tyre, mënyra e monitorimit të depozitimit të tyre në anije, si dhe mënyra e dorëzimit të tyre në porte.

Pas aderimit të Republikës së Shqipërisë në këtë konventë, Organizata Ndërkombëtare Detare (IMO) miratoi edhe aneksin VI, i cili parashikon rregulla për mbrojtjen e ajrit nga emetimi i gazeve nga djegia e karburanteve nga anijet.

Megjithëse ndotja e ajrit nga anijet nuk ka efekt të drejtpërdrejtë dhe të dukshëm nga popullsia, siç është rasti i një incidenti me derdhjen e naftës, ajo shkakton një efekt kumulativ që kontribuon në problemet e përgjithshme të cilësisë së ajrit të hasura në popullsinë e shumë zonave, si dhe ndikon në mjedisin natyror, si shiu acid etj.

MARPOL aneksi VI është miratuar për herë të parë në vitin 1997 dhe ka si qëllim kufizimin e ndotësve kryesorë të ajrit të përfshirë në gazrat e shkarkimit të anijeve, duke përfshirë oksidet e squfurit (SOx) dhe oksidet e azotit (NOx), dhe ndalon emetimet e qëllimshme të substancave që shkatërrojnë ozonin (ODS). Aneksi VI gjithashtu rregullon djegien e karburanteve nga anijet dhe emetimet e komponentëve organikë të paqëndrueshëm (VOC) nga cisternat.

Pas hyrjes në fuqi të aneksit VI të konventës MARPOL, më 19 maj 2005, Komiteti i Mbrojtjes së Mjedisit Detar (MEPC), në seancën e 53-të (korrik 2005), ra dakord të rishikojë MARPOL shtojcën VI, me qëllim forcimin ndjeshëm të kufijve të shkarkimeve, duke pasur parasysh zhvillimet teknologjike dhe eksperiencat e zbatimit deri më sot. Si rezultat i ekzaminimit trevjeçar, MEPC 58 (tetor 2008) miratoi rishikimin e aneksit VI të konventës MARPOL dhe kodin teknik NOx 2008, i cili hyri në fuqi më 1 korrik 2010.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Projektligji është në përputhje me programin e qeverisë, i cili, në kapitullin “Integrimi në Bashkimin Evropian”, përcakton se “Zbatimi me korrektësi i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (MSA), përmbushja e pjesës së mbetur nga 12 prioritetet e planit të veprimit, janë elemente kryesore për cilësinë dhe shpejtësinë e procesit të aderimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian”.

Miratimi i projektligjit është parashikuar si një nga angazhimet e ministrisë përgjegjëse për transportin në Strategjinë Sektoriale të Transportit, 2016-2020, dhe planit të veprimit miratuar me vendimin nr.811, datë 16.11.2016, të Këshillit të Ministrave, ku në projektin strategjik 1, objektivi 1.1, është përcaktuar “Përmirësimi i sistemit rregullator detar në pajtim me standardet dhe rregulloret e IMO-së dhe Bashkimit Evropian” dhe veprimi prioritar detar 1 “Ratifikimi dhe nënshkrimi i rregulloreve të IMO-së dhe Bashkimit Evropian për sigurinë, e parrezikshmërinë detare, mbrojtjen e mjedisit dhe menaxhimin bregdetar”.

Projektligji nuk është parashikuar në planin analitik të projektakteve të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë për vitin 2019.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Ndryshimet kryesore në aneksin VI të konventës MARPOL kanë si qëllim uljen progresive në rang global të emetimeve dhe grimcave të SO_x, NO_x dhe futjen e zonave të kontrollit të emetimeve (ECA) për të zvogëluar emetimet e ndotësve të ajrit.

Sipas aneksit VI të rishikuar të konventës MARPOL, kufiri global i squfurit do të zvogëlohet nga 3.50% në 0.50%, dhe do të jetë efektiv nga 1 janari 2020, në varësi të një rishikimi të fizibilitetit që do të përfundojë jo më vonë se viti 2019.

Komiteti i Mbrojtjes së Mjedisit Detar MEPC 70 (tetor 2016), gjatë trajtimit të masave për mbrojtjen e ajrit nga karburantet e anijeve, mbajti në konsideratë një vlerësim të kapaciteteve së naftës që përdoret si karburant për mjetet lundruese, për të bazuar vendimin që do të merrej nga shtetet anëtare të aneksit VI, të konventës MARPOL, si dhe vendosi që standardi i naftës së karburantit të anijeve (kufiri i squfurit 0.50%) të hyjë në fuqi në mënyrë të përshkallëzuar duke filluar më 1 janar 2020.

Kufijtë e aplikueshëm në ECA për SO_x dhe lëndët që lidhen me të u ulën në 0,10% nga 1 janari 2015.

Ulje progresive në emetimet e NO_x nga motorët e mjeteve lundruese me naftë të instaluar në anije janë gjithashtu të përfshira, me një kufi emisioni “Niveli II” për motorët e instaluar në një anije të ndërtuar më ose pas 1 janarit 2011; dhe një kufi më i rreptë i emetimeve “Niveli III” për motorët e instaluar në një anije të ndërtuar më ose pas 1 janarit 2016, që operon në zonat ECA (zona e kontrollit të emetimeve). Motorët e mjeteve lundruese me naftë të instaluar në një anije të

ndërtuar më ose pas 1 janarit 1990, por para 1 janarit 2000, kërkohet të përputhen me kufijtë e emetimeve “Niveli I”, nëse një metodë e aprovuar për atë motor është certifikuar nga një administratë detare.

Kodi teknik i rishikuar NOx 2008 përfshin një kapitull të ri të bazuar në qasjen e rënë dakord për rregullimin e motorëve ekzistues (para 2000) të vendosur në aneksin VI të konventës MARPOL, dispozitat për një metodë matjeje dhe monitorim i drejtpërdrejtë, një procedurë certifikimi për motorët ekzistues dhe ciklet e provës, të cilat aplikohen për motorët e nivelit II dhe të nivelit III.

Me MEPC 66 (Prill 2014) IMO-ja miratoi ndryshimet në rregulloren 13, të aneksit VI, të konventës MARPOL, lidhur me datën efektive të standardeve NOx, niveli III. Ndryshimet parashikojnë që standardet e NOx, niveli III, të zbatohen në një motor *diesel*, që është i instaluar në një anije të ndërtuar më ose pas 1 janarit 2016, e që vepron në zonën e kontrollit të emetimeve që janë të përcaktuara për kontrollin e emetimeve NOx.

Për më tepër, kërkesat e nivelit III do të zbatoheshin për motorët e instaluar me naftë kur veprojnë në zona të tjera të kontrollit të emetimeve që mund të përcaktohen në të ardhmen për kontrollin e nivelit III NOx. Niveli III do të zbatohet për anijet e ndërtuara në ose pas datës së miratimit nga Komiteti i Mbrojtjes së Mjedisit Detar të një zone të tillë të kontrollit të emetimeve ose në një datë të mëvonshme, siç mund të specifikohet në ndryshimin që përcakton zonën e kontrollit të emetimeve NOx niveli III.

Më tej, kërkesat e nivelit III nuk zbatohen për një motor *diesel* të instaluar në një anije të ndërtuar para 1 janarit 2021 me më pak se 500 tonazh bruto, me gjatësi 24 m ose më shumë, i cili është projektuar posaçërisht dhe përdoret vetëm për qëllime rekreative.

Rishikime në rregulloret për substancat që shkatërrojnë ozonin, përbërjet organike të paqëndrueshme, djegien e dërgesave të anijeve, objektet e pritjes dhe cilësinë e karburantit u bënë gjithashtu me rregulloret për disponueshmërinë e naftës së karburantit.

Masat e rishikuara pritet të kenë një ndikim domethënës të dobishëm në mjedisin atmosferik dhe shëndetin e njeriut, veçanërisht për ata njerëz që jetojnë në qytetet portuale dhe komunitetet bregdetare.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji është në përputhje me Kushtetutën dhe, konkretisht, me nenin 121 të saj, ku përcaktohet se “Ratifikimi dhe denoncimi i marrëveshjeve ndërkombëtare nga Republika e Shqipërisë bëhet me ligj në rastet kur ato kanë të bëjnë me miratimin, ndryshimin, plotësimin ose shfuqizimin e ligjeve” dhe nenin 18, të ligjit nr.43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”.

Gjithashtu, projektligji është në përputhje me Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit, ratifikuar me ligjin nr.9590, datë 27.7.2006, “Për ratifikimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe komuniteteve evropiane e shteteve të tyre anëtare”. Pika 2, e kapitullit III, “Ofrimi i shërbimeve”, të nenit 59, përcakton se palët angazhohen të respektojnë detyrimet ndërkombëtare dhe evropiane në fushën e standardeve të sigurisë dhe të mjedisit.

Miratimi i projektligjit është në përputhje me Strategjinë Sektoriale të Transportit, 2016-2020, dhe planin e veprimit, miratuar me vendimin nr.811, datë 16.11.2016, të Këshillit të Ministrave, ku, në projektin strategjik 1, objektivi 1.1, është përcaktuar “Përmirësimi i sistemit rregullator detar në pajtim me standardet dhe rregulloret e IMO-së dhe Bashkimit Evropian” dhe veprimi prioritar detar 1 “Ratifikimi dhe nënshkrimi i rregulloreve të IMO-së dhe Bashkimit Evropian për sigurinë e parrezikshmërinë detare, mbrojtjen e mjedisit dhe menaxhimin bregdetar”.

Miratimi i projektligjit bëhet në zbatim të detyrimeve që ka Republika e Shqipërisë si anëtare e Organizatës Ndërkombëtare Detare (IMO) për aderimin në të gjitha konventat ndërkombëtare në fushën e detarisë, të ndryshimeve të tyre dhe rezolutave të IMO-së për plotësimin e standardeve ndërkombëtare në fushën e detarisë.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Projektligji nuk ka përafrim me ndonjë *acquis* të Bashkimit Evropian.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Konkretisht, kjo iniciativë propozuese përmban:

1. Tekstin e konsoliduar të aneksit VI, të konventës MARPOL, duke përfshirë edhe amendamentet e miratuara nga rezolutat MEPC.271(69) dhe MEPC.278(70).
2. Rregulloret për parandalimin e ndotjes së ajrit nga anijet, përkatësisht:

Kapitulli I - Të përgjithshme

- Rregullore 1 - Zbatimi;
- Rregullore 2 -Përkufizimet;
- Rregullore 3 - Kundërshtime dhe përjashtime;
- Rregullore 4 - Ekuivalentet;

Kapitulli II - Ekzaminimi, certifikimi dhe mjetet e kontrollit

- Rregullore 5 - Inspektimi/Komisionimi;
- Rregullore 6 - Lëshimi ose miratimi i certifikatave dhe deklaratave të pajtueshmërisë në lidhje me raportimin e konsumit të karburantit;
- Rregullore 7 - Lëshimi i një certifikate nga një palë tjetër;
- Rregullore 8 - Forma e certifikatave dhe deklaratave të pajtueshmërisë në lidhje me raportimin e konsumit të karburantit;
- Rregullore 9 Kohëzgjatja dhe vlefshmëria e certifikatave dhe deklaratave të pajtueshmërisë në lidhje me raportimin e konsumit të karburantit;
- Rregullore 10 - Kontrolli i Shtetit Portual për kërkesat operacionale/funksionale;
- Rregullore 11 - Zbulimi i shkeljeve dhe zbatimit;

Kapitulli III - Kërkesat për kontrollin e shkarkimeve nga anijet

- Rregullore 12 - Substanca ozonholluese;
- Rregullore 13 - Oksidet e azotit (NO_x);
- Rregullore 14 - Oksidet e squfurit (SO_x) dhe lënda e grimcuar;
- Rregullore 15 - Komponimet organike të paqëndrueshme (VOC);
- Rregullore 16 - Djegia në bordin e anijes;
- Rregullore 17 - Pajisjet e pranimit;
- Rregullore 18 - Disponibiliteti dhe cilësia e karburantit;

Kapitulli IV - Rregulloret për efikasitetin e energjisë për anijet

- Rregullore 19 - Zbatimi;
- Rregullore 20 - Arritja e indeksit të planit të efijencës së energjisë (Indeksi EEDI i arritur);
- Rregullore 21 - Indeksi EEDI i kërkuar;

- Rregullore 22 - Plani i menaxhimit të efijencës së energjisë në anije (SEEMP);
- Rregullore 22A - Mbledhja dhe raportimi i të dhënave për konsumin e karburantit të anijes;
- Rregullore 23 - Përkrahja e bashkëpunimit teknik dhe transferimit të teknologjisë në lidhje me përmirësimin e efijencës energjetike të anijeve;
- Kapitulli 5 - Verifikimi i pajtueshmërisë me dispozitat e këtij aneksi;
- Rregullore 24 - Zbatimi;
- Rregullore 25 - Verifikimi i pajtueshmërisë;

Shtojcat e aneksit VI

Aneksi I - Format i certifikatës ndërkombëtare të parandalimit të ndotjes së ajrit (IAPP) (rregullore 8);

Suplement i certifikatës ndërkombëtare për parandalimin e ndotjes së ajrit (Certifikata IAPP);

Aneksi II - Ciklet e testimit dhe faktorët e peshimit (Rregullore 13);

Aneksi III - Kriteret dhe procedurat për përcaktimin e zonave të kontrollit të emetimeve (Rregullore 13.6 dhe rregullore 14.3);

Aneksi IV - Miratimi i llojit/tipit dhe kufijtë e operimit për krematorët në anije (rregullore 16);

Aneksi V - Informacioni që do të përfshihet në dokumentin shoqërues të dorëzimit të depove të karburantit (Rregullore 18.5);

Aneksi VI - Procedura e verifikimit të karburantit për mostrat e karburantit të Aneksit VI të MARPOL (Rregullore 18.8.2);

Aneksi VII - Zonat e kontrollit të emetimeve (Rregullore 13.6 dhe 14.3);

Aneksi VIII- Formulari i certifikatës ndërkombëtare të efijencës së energjisë (IEE);

Suplement i certifikatës ndërkombëtare të efijencës së energjisë (Certifikata IEE)

Aneksi IX - Informacioni që duhet të dorëzohet në bazën e të dhënave të konsumit të karburantit të anijeve të IMO-së;

Aneksi X - Formulari i deklaratës së pajtueshmërisë - raportimi i konsumit të karburantit.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT

Ngarkohet ministria përgjegjëse për transportin detar dhe institucionet në varësi të saj për ndjekjen dhe zbatimin e këtij projektligji.

VIII. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Marrëveshja që propozohet për aderim ka si objekt përmirësimin dhe mirëpërcaktimin e detyrave të institucioneve zbatuese, si dhe të sigurojë standarde të njëjta për të gjitha shtetet anëtare lidhur me kërkesat për sigurinë e parandalimit të ndotjes së ajrit nga anijet.

Aktualisht, anijet me flamur shqiptar janë të detyruara të mbajnë certifikatat e përmendura në aneksin VI, me anën e të cilave garantojnë se i plotësojnë të gjitha kushtet dhe kriteret për mbrojtjen e ajrit, pasi konventa i detyron të gjitha anijet që ti plotësojnë këto kushte dhe të mbajnë këto certifikata. Në rastet kur anijet prekin porte detare të një shteti anëtar të aneksit VI, administrata detare e këtij porti do të inspektojë mbajtjen e këtyre certifikatave edhe nga anijet që mbajnë flamurin e një shteti jo anëtar. Mosekzistenca e këtyre certifikatave në bordin e anijes do të sjellë si pasojë moslejimin e lundrimit të anijeve, si dhe do t'i detyrojë pronarët e anijeve që të mirëmbajnë anijet, duke i plotësuar të gjitha kushtet e nevojshme teknike sipas kërkesave të kërkuara nga Organizata Ndërkombëtare Detare (IMO) dhe Bashkimi Evropian (EU).

Për sa më sipër, duke vlerësuar detyrimet e administratës detare, shprehemi se miratimi i këtij projektligji nuk do të sjellë efekte financiare shtesë për buxhetin e shtetit.

KËSHILLI I MINISTRAVE